



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.137 dt.12.09.1997

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.12.09.1997, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike e Shërbimeve “Mbi gjendjen e furnizimit të Tiranës me ujë të pijshëm në vitin 1997 dhe rrugët e përmirësimit të saj” bazuar në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”

VENDOSI

I. Për zgjidhjet afat shkurtër :

1. Të forcohet kontrolli i Bashkisë në aktivitetin e Ndërmarrjes së Ujësjiellësit.
2. T’i rekomandohet Kryetarit të Bashkisë pezullimin e drejtorit aktual të Ndërmarrjes së Ujësjiellësit dhe deri në emrimin e ri të komandohet tjetër.
3. Të mbyllen të gjitha lidhjet në linjat e ujësjiellësit që janë në kundërshtim me kushtet teknike e që çënojnë furnizimin me ujë të qytetarëve. Ku shihet e nevojshme të hapen çesma publike.
4. Të rregullohet regjimi i ujit duke vendosur konsumatorët me pozitë të barabartë.
5. Të shfrytëzohen në maksimum rezervat ujore të puseve ekzistuese si edhe të puseve që nuk punojnë.
6. Të ndërhyhet e të likujdohen detyrimet financiare që kanë institucionet ndaj Ndërmarrjes së Ujësjiellësit.
7. T’i kërkohet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit që të vihen pjesërisht në punë 25 km tubacione të shtruara nga Firma Italiane “Falkone”.
8. T’i kërkohen Ministrisë së Mbrojtjes 3 bote për furnizim me ujë të pijshëm.
9. T’i kërkohet Ministrisë Punëve Publike dhe Transportit që Ndërmarrja e Ujësjiellësit Tiranë t’i kalojë në vartësi të saj për vet problemet e shumta që lidhen me të.

II.Për zgjidhjet afatgjata :

T’i kërkohet Ministrisë Punëve Publike e Transportit që :

- 1.Të bëhet studim i rrjetit të brendshëm të Tiranës.
- 2.Të rifillojnë brenda datës 19.09.1997 punimet në veprën e Bovillës që vera e vitit 1998 ta gjejë Tiranën me ujë

**KRYETARI
ORHAN SAKIQI**

KRYETARI

ORHAN SAKIQI